## Titulli i lëndës: GJUHË TURKE 1

| Informatat themelore për lëndën | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Filologjisë - Dega e Orientalistikës |
| Titulli i lëndës: | Gjuhë Turke I |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi i lëndës: | Lënda obligative |
| Viti i studimeve: | II |
| Numri i orëve në javë: | 1+2 |
| Kreditë ECTS: | 5 |
| Koha / Vendi: | Prishtinë |
| Mësimdhënësi: | Pro.ass.dr. Zeqije Xhafçe |
| Të dhënat kontaktuese: | Zekije.xhafqe@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Përmbajtja e kësaj lënde është mësimi i stundenteve duke përcjellur nivelin e njohjes së gramatikës dhe të leksikut, nëpërmjet simulimit të disa situatave të bisedimit. Gjatë ushtrimeve ushtrohen dhe zhvillohen shkathtësitë kryesore të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit nëpërmes temave të përgatitura për mësimin e gjuhës turke si gjuhë e huaj. Niveli i kursit është A1. Gjatë ligjeratave mësohen prapashtesat e shumësit, mbaresat rasore, prapashtesat pronësore, ndërtimi i togëfjalshave dhe harmonia vokalike, mësojmë si ta prezantojmë vetën dhe si të flasim për personin e tretë, përdorimin e përemrave vetore dhe ndërtimin e fjalive pyetëse me fjalë pyetëse, e pasurojmë leksikun duke mësuar fjalë të reja nga fusha të përditshme të jetës, zgjedhojmë folje në kohë të thjeshta dhe të përbëra, mësojmë të shprehurit e kohës, shkruajmë letra jozyrtare dhe zyrtare, kërkesa etj. |

| | |
|---|---|
| Qëllimet e lëndës: | - të komunikojnë lirshëm në gjuhën turke,<br>- të zotërojnë aftësitë të situatave kryesore të bisedës siç janë përshëndetje, prezantimi, shitblerje dhe situata tjera të ndryshme nga jeta e përditshme,<br>- të shtrojnë pyetje, dëgjojnë në mënyrë aktive idetë e të tjerëve, kuptojnë tekste të shkruara dhe të folura<br>- të zgjerojnë fjalorin dhe zhvillojnë gramatikën. |

| | |
|---|---|
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të këtij kursi studenti : |
| | - njeh lakimin e emrave,<br>- ndërton e fjalë dhe fjali të thjeshta,<br>- zgjedhon folje në kohën e shkuar, kohën e ardhme,<br>- ndërton fjali këpujore |
| | - prezanton vetën dhe personin e tretë me karakteristikat fizike dhe psiqike. Emërton dhe identifikon sende dhe koncepte themelore |
| | - përzgjedh mjete gjuhësore të përshtatshme për të shprehur konkludime të thjeshta nga ilustrimet vizuale dhe bisedat audiovizuale |
| | - zhvillon biseda të thjeshta me temat nga jeta e përditshme në shtëpi, në shitore, në shkollë |
| | - përshkruan ambiente të brendshme dhe të jashtme siç janë shtëpia, lagje, qyteti etj. |
| | - vlerëson ngjarjet e thjeshta nga jeta e përditshme siç janë ditëlindja, regjistrimi në fakultet, etj. Krahason situata nga të kohës së shkuar me situatat e kohës së tashme, shpreh planet për të ardhmen |

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhjeme rezultatete nxënies së studentit)**

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjëratat | 1 (45 min) | 15 | 15 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | 2 (90 min) | 15 | 30 |
| Punë praktike | 20 min | 15 | 5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Përgatitje për test intermediar | 30 min | 2 | 1 |
| Konsultime me mësimdhënësin | 20 min | 15 | 3 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi i seminarit | 2 | 3 | 6 |
| Detyrë shtëpie | 1 | 5 | 5 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 2 (90 min) | 15 | 30 |
| Përgatitja për provimin final | 3 | 7 | 21 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 3 | 2 | 6 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 1 | 1 | 1 |
| | | | 123 orë<br>123/25=<br>4,92 ECTS |

| | |
|---|---|
| Metodat e mësimdhënies: | Gjuhë Turke I është mësim i rregullt dhe mësimi mbahet në mënyrë grupore dhe 1+2 orë në javë. Forma e ligjerimit është praktike dhe interaktive.<br>Metodat e zbatuara gjatë ligjeratës janë:<br>- Metoda e garamatikës-përkthimit,<br>- metoda direkte e cila bazohet në dialogje ose tregime të shkurtra me të cilët tërhiqet interesi i studenteve dhe e cila bazohet në dëgjim, lexim, kuptim dhe bisedë,<br>- metoda e bazuar në detyra,<br>- metoda audio-linguale,<br>- metoda audiovizuale,<br>- metoda komunikative dhe eklektike. |
| Metodat e vlerësimit: | Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%.<br>Vijueshmëria e studentit 10%;<br>Kollokviumi 30%<br>Provimi final 60%. |
| Literatura primare: | 1. Yeni İklim Turkçe A1 Ders Kitabı, z-kitap<br>2. Mehdi Polisi (2009). *Gramatika e gjuhës turke.* Shkup: Logos-a.<br>3. Korkmaz, Zeynep, Türkiye Türkçesi Grameri, Türk Dil Kurumu Yayınları, Ankara, 2009 |

| Literatura shtesë: | 1. *Jaklin Kornfilt, Turkish Grammar (Descriptive Grammar), Routledge, London, 1997*3.<br>2. Lars Johanson (2021). *Turkic* (Cambridge Language Surveys). Cambridge: Cambridge University Press. https://doi.org/10.1017/9781139016704<br>3. *Veprat klasike dhe bashkëkohore letrare turke* |
|---|---|

| **Hartimi i planit mësimor** | |
|---|---|
| Java | Titulli i ligjëratës |
| Java 1: | Takimi. Fjalët pyetëse: Kush? Ç'? Ku?<br>Ndërtimi i fjalisë emërore. Fjalët *Var* dhe *Yok* |
| Java 2: | Koha e tashme -(iyor).<br>Mbaresat rasore*: -(y)E, -De, -Den* |
| Java 3: | Të shprehurit e kohës<br>Emrat foljore: *-DiktEn sonra, -mEdEn önce*<br>Parafjalët: *-(y)E kadar, -DEn önce, -Den sonra* |
| Java 4: | *Familja ime dhe miqtë e mi*<br>Kategoria e përkatësisë: *-(i)m, -(i)n, -(i)miz, -(i)niz, -(ler/s)i* |
| Java 5: | *Shtëpia dhe Lagjja jonë*<br>Togfjalëshi i përcaktuar *emër-(n)in + emër-(ler/s)i*<br>Togfjalëshi i pacaktuar *emër+ emër-(s)i*<br>*Qytetet* - Togëfjalëshi zinxhiror |
| Java 6: | Koha e shkuar e përcaktuar *–Di*<br>Folje këpujore në kohën e shkuar *–(y)di (< -(i)yor i-di)* |
| Java 7: | *Kujtimet*<br>Koha e pakryer e së shkuarës: *-(i)yordu (< -(i)yor i-di)*<br>Gjerundi *iken (-ken)* |
| Java 8: | ***Kolokviumi*** *(1 orë)*<br>*Ç'farë të hamë?*<br>Mënyra urdhërore *-sIn, -(y)in(iz), -sin(ler)*<br>Mënyra dëshirore *-(y)E* |
| Java 9: | Përdorimi i lidhëzës *ile*<br>Mbiemërzimi : *-li, -siz*<br>*Kuzhinat botërore*<br>Shkallat e mbiemrave: sh. krahasimore *-den daha*<br>dhe sh. e superlativit: *en* |

| | |
|---|---|
| Java 10: | Burokracia: Letrat zyrtare, kërkesat, ankesat etj.<br>Kundrinori i drejtë (mbaresa rasore e kallëzores -i) |
| Java 11: | *Ne jemi në telashe*<br>Koha e tashme, gjuhë zyrtare –*mekte* |
| Java 12: | *Kërkoj ndihmë*<br>Përemri lidhor –*ki*<br>Lidhëzat *: de/da* |
| Java 13: | *Planet e tua*<br>Koha e ardhme –(y)ecek<br>*Ç'farë do të ndodh?*<br>Fjalia emërore me në kohën e ardhme *olacak* |
| Java 14: | Pasfjalët : gibi, kadar<br>E ardhmja e së shkuarës -*ecekti* |
| Java 15: | **Kolokvium** |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

Për të pasur sukses më të mirë dhe më të lehtë në përvetësimin e lëndës janë disa kërkesa që duhet t'u përmbahet studenti. Të gjitha ato mund të përfshihen shkurt: vijimi i rregullt i mësimit; interesimi dhe angazhimi i tij për ta përvetësuar lëndën; sjellja e mirë dhe korrekte; respektimi i mendimeve; ndihma reciproke etj. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet e tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet, janë të ndaluara.